



# KONTROLI I LARTË I SHTETIT

## KRYETARI

---

Nr.531/5 Prot.

Tiranë, më 27 /09/ 2016

### V E N D I M

Nr 119, Datë 27.09.2016

#### PËR

### **EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT FINANCIAR TË USHTRUAR NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME “MBI LIGJSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin të paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit të dhënë nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, si dhe mendimin mbi cilësinë e auditimit të dhënë nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, konstatoj se, në Institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme (Aparati) janë administruar vlerat materiale dhe monetare të vëna në dispozicion në përputhje me rregullat dhe standardet buxhetore duke reflektuar sisteme të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të kujdesshëm. Janë bërë përpjekje për një vlerësim të drejtë të risqeve në realizimin e proceseve duke reflektuar impakt pozitiv në arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pavarësisht nga nevoja për përmirësime të trajtuara sipas gjetjeve nga ky auditim.

Në përfundim në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

### V E N D O S A:

- I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” të ushtruar në Prokurorinë e Përgjithshme, deri më 31.12.2015.
- II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## A. OPINIONI I AUDITUESIT

### Opinion i pakualifikuar.

Në gjykimin e KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700<sup>1</sup> dhe ISSAI 1200<sup>2</sup>, pasqyrat financiare vjetore të Institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme (Aparati), paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të institucionit më datë 31.12.2015. I njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

Është në përgjegjësinë tonë, si auditues të pavarur, të shprehemi se evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar.

## B. MASA ORGANIZATIVE

### GJETJA 1.

Nga auditimi i procedurave për menaxhimin financiar është konstatuar se janë realizuar kushtet e nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli në sistemin e prokurorisë së përgjithshme (aparati), ndërkohë që nuk mundemi të japim siguri për njësitë e varësisë dhe strukturat e tyre. Gjithsesi nga auditimi rezultoj se vlerësimi i riskut operacional bëhet vetëm në plotësim të kërkesave rregullative, duke reflektuar formalizëm në ndjekjen e kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Konstatohet se nuk ka një proces të mirë rregulluar lidhur me zbatimin e kërkesave të etikës dhe garantimin e penalizimit të rasteve të shkeljeve etike në Institucion. Në Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”, miratuar me urdhrin nr.121, datë 21.06.2010, janë përcaktuar hallkat e vendimmarrjes, si dhe ndarja e detyrave në mënyrë të përshtatshme për të eliminuar pjesëmarrjen e një punonjësi në disa detyra. Rregullorja nuk i përgjigjet plotësisht strukturës aktuale të Prokurorisë dhe krijon edhe risqe të brendshme lidhur me objektivat që duhet të sigurojë një sistem kontrolli i drejtë dhe efikas.

Decentralizimi e lë menaxhimin e lartë të painformuar për veprimet e ndërmarra nga niveli i ulët organizativ dhe kështu redukton mundësinë e zbulimit të gabimeve dhe mashtrimit. Mungon një procedurë e shkruar referuar raportimit të gabimeve dhe rasteve të mashtrimit.

Auditimi i institucionit nga strukturat e brendshme të auditimit, nuk është bazuar në riskun e materialitetit dhe përgjithësisht është shmangur misioni i auditimit financiar. Struktura e auditit të brendshëm me mungesa në staf nuk arrin të japë siguri për sistemet e kontrollit dhe rregullshmërinë e aktivitetit të njërive të varësisë për sa kohë që nuk mund të mbulojë me auditim as 50% të njërive të varësisë në një vit kalendarik.

### NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

<sup>1</sup> ISSAI 1700: Objektivi i auditimit është formimi i një opinionit për pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e auditimit dhe shprehja e qartë e opinionit në një raport të shkruar, ku përshtatet baza e tij.

<sup>2</sup> ISSAI 1200: Gjatë auditimit financiar, objektiva kryesor të audituesit janë dhënia e një sigurie të arsyeshme, nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale, në mungesë të mashtrimeve apo gabimeve duke përbërë bazën për shprehjen e opinionit nga audituesi si dhe raportimi në përputhje me standardet dhe gjetjet nga auditimi.

## **REKOMANDOJMË**

Nga strukturat përgjegjëse (GMS), të bëhet një vlerësim me i plotë i riskut operacional, të merren masa për minimizimin e tij jo vetëm duke pasuruar bazën rregullative, por edhe duke e kombinuar me masa ndëshkimore ndaj personave që i shmangen përgjegjësiwe funksionale.

Institucioni të marrë masa për forcimin e strukturave të auditit të brendshëm, plotësimin e saj sipas bazës ligjore në fuqi, me qëllim mbulimin me misione auditimi të të gjitha njësive dhe në afatet e planifikuara. Struktura e Auditit të Brendshëm duhet të thellohet në analizat mujore e tremujore që monitorojnë performancën buxhetore, të kryej auditime përputhshmërie bazuar në riskun e materialitetit dhe sidomos të kryej auditimin financiar në njësitë e varësisë. Të marren masa për të rregulluar procedurat e zbulimit dhe raportimit të rasteve të gabimit me qëllim për të minimizuar risqet e mashtrimit në njësitë e varësisë.

*Menjëherë*

### **GJETJA 2.**

Nga auditimi procedurave për menaxhimin financiar dhe kontrollin, u konstatua se nga drejtimi nuk janë miratuar procedura formale për identifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e rreziqeve strategjike dhe operationale në nivel institucioni (bashkë me njësitë e varësisë). Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek nëpunësi i lartë autorizues lidhur me regjistrin e rreziqeve si dhe mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut.

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Lartë

## **REKOMANDOJMË**

Grupi i manaxhimit strategjik të hartojnë plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve, të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, duke emëruar personin përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza periodike për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

*Menjëherë*

### **GJETJA 3.**

Buxheti në Prokurorinë e Përgjithshme, si element i rëndësishëm për të siguruar efektivitetin e funksionimit të institucionit, konstatohet se nuk ka qenë aq i mbështetur në burime, fakt që vërtetohet nga ndryshimet që kanë ndodhur gjatë periudhës dhe transferimi i fondeve nga një zë në një zë tjetër buxhetor. Konstatohet se gjatë vitit janë reflektuar ndryshime të programit fillestar miratuar me Ligjin 160/2014 datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015". Ndryshimet kanë ndodhur me inventarizime të cilat janë ulur me 89 milion lekë. Ndërsa referuar programit të buxhetit sipas ligjit 160/2014 për vitin 2015, ulja ka ndodhur në zërin paga 34.5 milion lekë.

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Lartë

## **REKOMANDOJMË**

Procesi i programimit buxhetor të udhëhiqet nga analiza të kujdesshme të nevojave dhe burimeve, sipas kushteve në të cilat do të realizohet ky buxhet. Kjo kërkon diskutim më të mbështetur dhe me transparencë të procesit, i cili do të ndihmojë arritjen e një programimi realist, sa më afër nevojave dhe forcimin e pavarësisë të këtij institucioni.

Rialokimi i fondeve buxhetore duhet të bëhet vetëm mbështetur në strukturën bazë, pra fondet për shpenzime korente nuk mund të përdoren për investime (231) dhe anasjelltas, rekomandojmë që rishpërndarja të bëhet vetëm për zëra të së njëjtës kompetencë.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

#### **GJETJA 4.**

Nuk arritëm të krijojmë bindje për saktësinë e raportimit të konsoliduar të këtij institucioni, për shkak të formalitetit të konstatuar në realizimin e këtij procesi. Nuk kishte asnjë procedurë kontrolli apo dhe verifikimi paraprak të pasqyrave të njësisë të varësisë si dhe konstatuam mungesë të plotë të shënimeve shpjeguese të lidhura me këto pasqyra financiare. Nga auditimi i brendshëm nuk kishte mision auditimi të lidhura me auditimin financiar dhe certifikimin e shifrave të pasqyruara në këto pasqyra në njësitë e ndryshme të varësisë. Në gjykimin tonë risku për paraqitje të drejtë dhe saktë të transaksioneve apo ligjshmërisë së veprimeve të pasqyruara brenda periudhës kontabël është i lartë.

Pasqyrat financiare janë hartuar si një bashkim mekanik i pasqyrave të 31 njësisë. Për lëvizjet e aktiveve, por edhe për rritjet e detyrimeve afatshkurtra nga njësitë e varësisë nuk jepen sqarime dhe shpjegimeve të ndryshmeve gjatë vitit ushtrimor. Pra, bilanci i konsoliduar nuk jep mundësi të kuptohen arsyet e lëvizjeve në zërat e ndryshëm të bilancit. Konstatohet se institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme i mungon regjistri i konsoliduar i aktiveve të plotësuar sipas kërkesave të Udhëzimit 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### **NIVELI I PRIORITETIT**

I Lartë

#### **REKOMANDOJMË**

Institucioni të krijoj regjistrin e plotë të aktiveve të institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme (bashkë me njësitë e varësisë). Monitorimi i saktësisë së evidencës së aktiveve duhet të jetë një proces i vijueshëm nga njësia e auditit.

Nga Drejtoria Ekonomike të vlerësohet procesi i hartimit të Pasqyrave financiare të konsoliduara me prioritet, shoqëruar me sqarimet përkatëse të veprimeve, duke synuar në një proces integral dhe të monitorueshëm gjatë gjithë periudhës. Rekomandojmë rritje të intervaleve të raportimit nga njësitë e varësisë të paktën në periudhë 6-mujore kjo për të provigjonuar dhe ngjarje me ndikim në pasqyrat e fund vitit, si dhe forcim të kapaciteteve njerëzore të përfshira në evidentimin e transaksioneve financiare dhe raportimin e tyre.

Nga Auditimi i Brendshëm të verifikohet rregullshmëria e hartimit të pasqyrave financiare në të gjitha njësitë.

*Menjëherë*

#### **GJETJA 5.**

Nga auditimi i inventarizimit të aktiveve u konstatua se aparati i PP, nuk ka të hipotekuar ndërtesën e truallin dhe ndërtesat e prokurorive në rrethe, të cilat janë në përdorim të institucionit dhe në pronësi të shtetit. Sipas shkresës nr.3096 prot, datë 24.11.2006 dërguar në Ministrinë e Brendshme, nga inventarizimi i pronave publike, Prokuroria e Përgjithshme ka në përdorim një sipërfaqe totale 3022 m<sup>2</sup> dhe ndërtesa me sipërfaqe 612.6 m<sup>2</sup>. Verifikimi i pronave në njësitë e varësisë ishte i pamundur të realizohej në këtë proces auditimi.

Gjatë inventarizimit në aparatet e Prokurorisë së Përgjithshme, për vitin 2014, kanë rezultuar materiale jashtë përdorimit në vlerën 26,029,509 lekë. Për nxjerrjen nga përdorimi, Komisioni ka zbatuar procedurat e përcaktuara në pikat 95-107 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave

nr. 30, datë 27.12.2011 (Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik) i ndryshuar. Ndërsa gjatë kryerjes së inventarizimit fizik për vitin 2015, komisioni ka konstatuar 153 artikuj jashtë funksionit për shkak të dëmtimeve të ndryshme si thyerje, skadim, etj, në vlerën 14,503,744.3 lekë, konstatojmë që nuk është kryer procedura për nxjerrjen nga përdorimi.

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Mesëm

### **REKOMANDOJMË**

Drejtoria ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme të inicioj procesin për nxjerrjen jashtë përdorimit sipas kërkesave dhe rregullave të përcaktuara në pikat 95-101 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, për vlerësimin e aktiveve të propozuar për daljen nga përdorimi, duke përfshirë edhe filmimin e hapave që ndjekë komisioni për asgjësimin e materialeve. Institucioni të ndjekë në vijimësi funksionalitetin e aktiveve, me qëllim të mos lejohet grumbullimi i vlerave materiale të mëdha, që bëjnë procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit më kompleks dhe më pak të auditueshëm.

Njësia e Auditit të Brendshëm të ndjekë realizimin e këtij procesi.

*Menjëherë*

### **GJETJA 6.**

Nga auditimi i zërit të pagave konstatuam se ka mospërputhje të të dhënave të pagës bruto, të raportuar sipas listë pagesave, me të dhënat e pasqyruara në pasqyrat financiare si dhe me të dhënat e situacioneve. Referuar të dhënave për buxhetin diferenca për vitin 2015 arrin në 1,435,473 lekë.

Nr	Viti	Listë pagesë	Në pasqyrat financiare	Listë pagesë/pasqyrave financiare	Të dhëna nga situacioni	Diferenca midis situacioni/pasqyra
1	2014	140,232,243	140,211,600	+ 20,643	140,351,192	+139,562
2	2015	128,383,499	127,340,828	+ 1,042,671	128,776,301	+1,435,473

Gabimi i konstatuar nuk konsiderohet material për të ndikuar në opinionin e dhënë për këto pasqyra.

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Mesëm

### **REKOMANDOJMË**

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse, gjatë vitit 2016 të kryejë sistemimin e shifrave të paraqitura në pasqyrat financiare të vitit 2015, të cilat rezultojnë me diferenca nga shpenzimet reale të kryera gjatë vitit dhe të pasqyruara korrektësisht në situacionet e konfirmuara nga thesari. Këto diferenca dhe sistemime të realizohen konform parimeve dhe rregullave të kontabilitetit financiar.

*Menjëherë*

### **GJETJA 7.**

Nga auditimi i zërave të bilancit konstatohet një nivel i shtuar i detyrimeve të cilat kryesisht i takojnë shpërblimit të ekspertizave në nivel institucioni. Nga auditimi i shpenzimeve të

lidhura me këtë zë kemi konstatuar disa problematika të cilat i referohen mungesës së një rregullimi adekuat të këtij shërbimi në rang institucioni.

Kështu lidhur me shpenzimet shpërblimit të ekspertëve të thirrur nga prokurorët për qëllime të hetimit, në zbatim të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë, konstatohet një praktikë jo e konsoliduar si në mënyrën e përzgjedhjes dhe të niveleve të shpërblimit të ekspertëve të cilat rezultojnë të jenë të fushave të ndryshme. Ky zë i shpenzimeve është material në nivel institucional por nuk është i rëndësishëm në strukturën e shpenzimeve të Aparatit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga auditimi i këtyre shpenzimeve në Aparatin e Prokurorisë, konstatuam se pagesa për ekspertizë, e kryer nga punonjës të institucioneve të tjera publike është bërë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.720, datë 25.11.1995 “Për shpërblimin e punonjësve buxhetor që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore shtetërore”, duke u paguar nga Prokuroria ndërkohë që aktet nënligjore të nxjerra nga vetë institucioni, kërkojnë që pagesa duhet të merret pranë qendrës së punës. Kjo praktikë është në kundërshtim me Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, i cili kërkon që tatimi mbi të ardhurat të mbahet në burimin e krijimit të tyre. Gjithsesi duhet të theksojmë se kërkesat që rregullojnë marrjen e shërbimeve të ekspertizës janë të hershme dhe nuk reflektojnë kërkesat e kohës.

Problematika ekzistojnë edhe në marrëdhënien me institucione të tjera shtetërore (mjekësia ligjore apo shërbimi zjarrfikës) të cilat sigurojnë ekspertiza në funksion të plotësimit të misionit të tyre dhe në mbështetje të punës së organit të hetimit, pasi nuk ka një unifikim të procedurave dhe të mënyrës së operimit ndërinstitucional në ligjet respektive. Ka detyrime të prapambetura në rritje të lidhura me këto shërbime megjithëse flitet për shërbime ndërmjet institucioneve publike.

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Lartë

## **REKOMANDOJMË**

Të ndërmerret një iniciativë ligjore për të konsoliduar praktikat e emërimit dhe të pagesës së ekspertëve të jashtëm të cilët në të gjitha rastet duhet të jenë të licencuar ose të caktuar nga strukturat shtetërore ku ata aderojnë, kjo do të saktësojë dhe rregullojë edhe marrëdhënien prokuror ekspert që në të gjitha rastet mbart riskun e konfliktit të interesit të padukshëm.

Duke e konsideruar një zonë me risk të lartë kërkojmë që auditimi i brendshëm të ndërmarrë në periudha ciklike misioni tematike lidhur me këtë lloj shpenzimi dhe rregullshmërinë e tij financiare

*Menjëherë*

## **GJETJA 8.**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit ka rezultuar se Prokuroria e Përgjithshme, ka funksionuar si Njësi e Përqendruar Prokurimi, për shërbimin e internetit, karburantit dhe të blerjes së materialeve të zyrave. Kemi konstatuar se niveli i efektivitetit nuk është i dëshiruari sepse kursimi nga fondi limit nuk është i lartë por gjithsesi vlen të theksohet se centralizimi i prokurimeve ruan nivel të mirë të efektiviteti dhe eficiencës në shpenzimin e burimeve krijon mundësi kontrolli më të lartë dhe monitorim të shpenzimeve në nivel njësisht. Një praktikë e tillë gjykohet e drejtë edhe duke njohur mungesën e kapaciteteve njerëzore të përgatitur për ta realizuar procedura prokurimi dhe për të ndjekur procesin e zbatimit të kontratës me OE, në nivel njësisht varësie

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Mesëm

### **REKOMANDOJMË**

Të bëhet një analizë e thelluara kosto/përfitim për të përcaktuar lloji i mallrave/shërbimeve që duhet të prokurohen në qendër dhe që sjellin jo vetëm eficiencë por edhe efektivitet në përdorim fondesh si dhe mundësojnë auditimin e plotë të shpenzimeve në nivel institucional. Të përcaktohet në bazë të një rregulloreje të brendshme niveli dhe lloji i shpenzimeve që mund të miratohen dhe realizohen nga vetë strukturat e varësisë kjo për të unifikuar procedurat por edhe për të rritur mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar.

*Menjëherë*

### **GJETJA 9.**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me blerje të vogël kemi konstatuar nivel të lartë të kursimit të fondit limit, si për vitin 2014 edhe për vitin 2015. Kemi konstatuar raste procedurash ku kursimi arrin edhe në nivel 40% të fondit të prokuruar, duke na çuar në konkluzionin se metodologjia e llogaritjes së fondit limit është jo e saktë, pavarësisht se proceduralisht është vepruar sipas kërkesave ligjore, duke llogaritur fondin limit bazuar vetëm në tre oferta nga operatorët ekonomik pa një analizë të brendshme të kostove. Nga ana tjetër kemi konstatuar se në të gjitha procedurat është shpallur fituese oferta ekonomiksht më e vogël, ndërkohë që operatori ekonomik fitues ka qenë gjithmonë i vetëm në konkurrim.

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Mesëm

### **REKOMANDOJMË**

Institucioni duhet të tregojë vëmendje më të madhe lidhur me programimin e shpenzimeve të cilat duhet të realizohen përmes prokurimit duke minimizuar procedurat me blerje të vogla të cilat përmbajnë edhe problematikën e llogaritjeve jo të sakta të fondit limit.

I rekomandojmë institucionit se përcaktimi i fondit limit të hedhur në prokurim, duhet të paraprihet edhe nga analiza të brendshme institucionale të kostove që shoqërojnë blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Procedurat e prokurimit në vlerë të vogël duhet ti largohen praktikave formale në plotësim të kërkesave ligjore.

*Menjëherë*

Nga KLSH të kërkohet plotësim i kërkesave ligjore në ligjin “Për prokurimin publik”, të cilat do ti prinin rrugën sjelljeve të koordinuara të firmave në procedurat e prokurimit si dhe do të minimizonte hyrjet në procedura prokurimi pa plotësuar të gjitha kriteret kualifikuese. Gjykojmë se vendosja e penaliteteve për operatorët të cilët bëhen pjesëmarrës të procedurave të prokurimit megjithëse nuk plotësojnë kriteret do të ishte një faktor frenues për sjellje të koordinuara.

*Menjëherë*

### **GJETJA 10.**

Në tenderat e zhvilluar me objekt “Shërbimi Network Data dhe shërbimi i aksesit të internetit” për Prokurorinë e Përgjithshme dhe institucionet e varësisë” është zbatuar kriteri s’kualifikimi “Zgjidhje të detajuar të ofrimit të shërbimit me fibrën optike në pronësi të tij” në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 5; germa ç, që parashikon “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për të përmbushur kontratën. Pavarësisht se në këtë procedurë është shpallur fituese oferta më e ulët krahasuar me

ofertat e tjera të kualifikuara, gjykojmë se një kërkesë e tillë nuk është plotësisht e mbështetur.

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Mesëm

### **REKOMANDOJMË**

AK të shqyrtojë me kujdes kriteret e vendosura, në mënyrë që mos të jenë përjashtuese, ndërkohë që në kuadër të sigurisë së informacionit AK të marrë masa që ky problem ti reflektohet APP-së dhe të zgjidhet kjo situatë.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

### **GJETJA 11.**

Në periudhën objekt auditimi, nga misioni i OSCE në Tiranë, institucionit i janë dhuruar në natyrë, dy aktive në sasi, pa përcaktuar çmimin dhe koston e tyre. Mbështetur në kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” pika 57 e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, u konstatua se, në aktivet e dhuruara mungon dokumentacioni shoqërues, akti i dhurimit ose letra zyrtare e njësisë donatore si dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të aktiveve nga personat e autorizuar.

## **NIVELI I PRIORITETIT**

I Mesëm

### **REKOMANDOJMË**

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që, dhuratat nga donator të ndryshëm të jenë të pajisura me të gjithë dokumentacionin shoqërues sipas kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë Vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**